



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I BASHKISË KORÇË**

**P/VENDIM**

**Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË KONSOLIDUAR PËR VEPRIMTARINË FINANCIARE DHE  
ZBATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KORÇË PËR VITIN 2022**

Këshilli i Bashkisë i qytetit të Korçës, në mbledhjen e tij të datës së sotme, pasi mori në shqyrtim “Raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2022”, paraqitur nga Ekzekutivi i Bashkisë, duke u bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” nenit 51 “Raporti vjetor i konsoliduar i zbatimit të buxhetit vendor”, ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 115/2021 “Për Buxhetin e vitit 2022”, udhëzimit nr. 9 datë 20.03.2018 i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, udhëzimit plotësues nr. 1 datë 10.01.2022 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2022”, VKB nr. 147 datë 22.12.2021 “Mbi miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë”, VKB nr. 6 datë 27.12.2022 “Për rishqyrtimin e VKB nr.147 datë 22.01.2021 “Për miratimin e buxhetit vjetor 2022 të Bashkisë Korçë” si dhe VKB nr.21 datë 10.02.2022 “Për përdorimin e të ardhurave të trashëguara të vitit 2021 të Bashkisë, Institucioneve të Varësisë në buxhetin e vitit 2022”, mbështetur në kompetencat që ka si dhe mbas diskutimeve dhe propozimeve të këshilltarëve:

**VENDOSI**

1. Të miratojë raportin e konsoliduar për veprimtarinë financiare dhe zbatimin e buxhetit të Bashkisë Korçë për vitin 2022.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Ekzekutivi i Bashkisë Korçë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”).

Sekretari i Këshillit Bashkiak  
**Eva NAÇI**

**K R Y E T A R**  
**Erion NEXHIPI**

Miratuar me \_\_\_\_\_vota  
Vota Pro \_\_\_\_\_  
Vota Kundër \_\_\_\_\_  
Vota Abstenim \_\_\_\_\_  
Zbardhur më datë \_\_\_\_\_